

# **ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TE ENERGIJISE ELEKTRIKE**

## **METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË ÇMIMIT TE UNIFIKUAR PER ENERGIJINE ELEKTRIKE TE PRODHUAR NGA HEC-et E RINJ ME FUQI TE INSTALUAR DERI NE 10 MW**

### **Autoriteti**

Metodologjia e llogaritjes së çmimit unik per energjine elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW te dhene me konçesion, është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” (me te gjitha ndryshimet) dhe te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 27, date 19.01.2007 “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se konçesioneve”.

### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj metodologjie është të percaktoje nje çmim unik per energjine elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, te dhene me konçesion, bazuar ne rolin dhe pergjegjesite e ERE-s per nxitjen e investimeve ne burime te reja gjeneruese , me synim rritjen e transparences si dhe krijimin e kushteve te qendrueshme afatgjata per pjesemarrjen e sektorit privat ne veprimtarine e prodhimit te energjise elektrike.

## 1. Termat e përdorur në metodologji

Termat e përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin si më poshtë:

- 1.1 **Çmimi unik** – çmimi i njejte i energjise elektrike i percaktuar nga ERE sipas kesaj metodologjie per HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, te dhene me konçesion.
- 1.2 **Çmimi mesatar i importit** - cmimi mesatar i importit te energjise elektrike i realizuar nga KESH sh.a. ne vitin paraardhes, qe rezulton si raport i vleres totale te fondit te shpenzuar per import me sasine totale te energjise elektrike te importuar ne te njejtin vit.
- 1.3 **Koeficienti i barabarte me 1.1** – Bonusi qe u jepet te licensuarve per energjine elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, per reduktimin e humbjeve ne masen 10 % te sasise te injektuar prej tyre ne sistem ne rrjet si pasoje e lidhjes se ketyre burimeve prane ngarkesave ne TM/TU.

## 2. Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

- 2.1 Kjo metodologji është hartuar ne mbeshtetje të dispozitave te Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” (me te gjitha ndryshimet), akteve te tjera ligjore që janë në fuqi në

Republikën e Shqipërisë, si dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE.

- 2.2 Energjia elektrike e prodhuar nga të HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhene me konçesion, injektohet direkt në rrjetin TM/TU në shpërndarje. Në rastet kur e kërkon konçesionari, KESH sh.a.(subjekti i furnizimit me energji elektrike të klienteve tarifore) detyrohet të blejë energjinë elektrike të prodhuar nga kjo kategori prodhuesish me kontrata afatgjate me qëllim rishitjeje tek klientet tarifore që furnizohen në rrjetin e shpërndarjes.
- 2.3 Çmimi unik llogaritet duke iu referuar çmimit mesatar të importit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. në vitin paraardhës.
- 2.4 Çmimi unik, sipas kësaj metodologjie, do të rregullohet në funksion të ndryshimeve të çmimit mesatar të importit të energjisë elektrike dhe normes mesatare të shkëmbimit Euro/Leke të publikuar nga Banka e Shqipërisë për të njëjtin vit.
- 2.5 Çmimi unik llogaritet për të gjithë HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhene me konçesion sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për Konçesionet” dhe VKM në zbatim të tij Nr.27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vleresimit dhe të dhenies së konçesioneve”.

### **3. Formula e llogaritjes se cmimit unik te energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, te dhena me konçesion**

- 3.1 Çmimi unik i energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, percaktohet nga ERE ne fillim te cdo viti.
- 3.2 Per te gjithë te liçensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, qe zgjedhin t'ia shesin energjine elektrike te prodhuar prej tyre KESH sh.a-se, çmimi unik llogaritet sipas formules se meposhtme:

$$P_U = P_I * 1.1 * R_{EX}$$

ku :

$P_U$  – Çmimi unik i energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW;

$P_I$  – Çmimi mesatar i importit te energjise elektrike te realizuar nga KESH sh.a. ne vitin paraardhes;

**Koefiçienti = 1.1** - Bonusi qe u jepet te liçensuarve per prodhimin e energjise elektrike nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW,

$R_{EX}$  - norma mesatare e shkembimit Euro/Lek te publikuar nga Banka e Shqiperise per vitin paraardhes;

#### **4 Dispozita përfundimtare**

Metodologjia e llogaritjes së çmimit unik për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me konçesion sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për Konçesionet” dhe VKM në zbatim të tij Nr.27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vleresimit dhe të dhënies së konçesioneve” u miratua nga Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike me Vendimin nr.24, datë 11/04/ 2007.